



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. 2-D/DPK
 Nr. Prot. 01-685/16
 Prot. No.
 Nr. f. lag. 02
 Datum 22-02-2016
 Broj stranica
 Date
 Nr. pages
 PESHKËTINE



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 22.02.2016, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-4273/15, për z. Sabri Ferati, Anëtar i Kuvendit Komunal në Vushtrri, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Sabri Ferati, Anëtar i Kuvendit Komunal në Vushtrri, dhe njëkohësisht person i autorizuar në bizneset private Ndërmarrja Ndërtimore "Kujtimi" dhe Sh.P.K "Kujtimi", është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Zyrtari i lartë, z. Ferati është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pas pranimit të kësaj shkrese, kemi njoftuar zyrtarin e lartë për gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej dhe për ndryshimet që duhet ti bëjë, për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

Zyrtari i lartë, z. Ferati ka pranuar rekomandimin e Agjencisë për të bërë ndryshimet e kërkuara në Agjencionin për Regjistrimin e Bizneseve, për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

Duke parë se procesi i ndryshimeve të kërkuara po zgjatë, Agjencia i ka bërë shkresën e dytë sipas procedurës ligjore që quhet “njoftimi paralajmërues”, me të cilin zyrtarit të lartë i është bërë e qartë se duhet të shmangët situata e konfliktit të interesit brenda afatit të caktuar, përndryshe do të pasojnë masat tjera sanksionuese të parapara me ligj.

Ndërkohë, zyrtari i lartë ka dërguar në Agjenci shkresat zyrtare të lëshuara nga Agjencioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI.03-02/625/16)(DPKI.03-02/664/16), në të cilën vërtetohet se zyrtari i lartë ka bërë shuarje vullnetare të biznesin privat Ndërmarrja Ndërtimore “Kujtimi”. Ndërsa në biznesin privat Sh.P.K “Kujtimi” z. Ferati është larguar nga funksioni menaxherial. Me këtë rast zyrtari i lartë ka shmang gjendjen e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

